



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 256 Prot.

Tiranë, më 15.09.2025

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
Shërbimi Kombëtar i Punësimit

TIRANË

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr.20, datë 26.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, i ndryshuar, VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin e **Specialistit pranë Sektorit të Statistikave dhe Analizave.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me formim në Shkencat Filologjike dhe të Edukimit.
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsimin e lartë ose që kanë lidhje me arsimin e lartë.
3. Të zotërojë gjuhën angleze, me dëshmi në nivel të avancuar.
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në administratën publike.
5. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë në përgjithësi dhe atij që lidhet me proceset e sigurimit të cilësisë.
2. Të ketë njohuri praktike në menaxhimin e proceseve të vlerësimit.
3. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese.
4. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore
10. Raport mjekësor si i aftë në punë.

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 10.10.2025, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Konceptoi: P.Dingo datw 15.09.2025

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al